



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:910925

Datë: 28.09.2021

Numri i dokumentit: 02220907

AC.nr.4442/2019

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi, dhe Milena Gjeriq, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.LL. nga fshati ..., Komuna e Glllogocit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson S.M., avokate me seli në Komuna Prishtinë, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK Sh.a), me seli në Komuna Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Fidane Shala, zyrtare ligjore, lidhur me kompensimin e pagave për shpërblim jubilar, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur nga e paditura, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1255/18, të datës 14.03.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 29.09.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e themeltë ankesa e të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. (KEK) me seli në Komuna Prishtinë, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1255/18 datë 14.03.2019, dhe gjykohet si vijon:

II. REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit R.LL. nga fshati ..., Komuna e Glllogocit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës sh. a (KEK), që paditësit, në emër të tre pagave për shpërblim jubilar, t'ia kompensojë shumën prej 1,548,00 Euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga dita e ushtrimit të padisë, me datë 23.04.2018, e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar, C.nr.1255/18, të datës 14.03.2019, Gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka vendosur si vijon : *“...I-APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR kërkesëpadinë e paditësit R.LL. nga fshati ..., Komuna e Glllogocit. II-DETYROHET e paditura Korporata Energjetike e Kosovës sh. a (KEK), që paditësit R.LL., t'ia kompensojë në emër të tre pagave jubilarë shumën prej 1,548,00 € me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga ushtrimi i padisë, me dt.23.04.2018*

deri në pagesën definitive, e të gjitha në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. III- DETYROHET e paditura që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 270.00 €, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm...”.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë e autorizuara e të paditurës, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 (pika e) dhe 201 (pika d), të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi ka ushtruar padi në Gjykatën Themelore duke kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit në emër të kompensimit të tre pagave jubilarë t'ia paguajë shumën e tërësishme në vlerë prej 1548.00 Euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive, dhe atë në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimin, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.1255/18 të datës 14.03.2019, e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata e shkallës së parë, ndër tjera ka theksuar se: *“...nga provat e administruara dhe nga ballafaqimi i palëve ndërgjyqëse, konstatohet se: mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi sipas vendimit të të paditurës nr.8382/0, të dt.26.02.2018, është pensionuar me dt.26.02.2018. Paditësi deri në momentin e pensionimit kishte punuar tek e paditura për mbi 30 vite dhe se të njëjtit me vendimin e të paditurës nr.8382/0, të dt.03.01.2018, i është njohur e drejta në 3 paga bazë mujore pas pensionimit, por nuk i janë paguar 3 paga jubilarë siç parashihet me Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive...”.*

Gjykata e shkallës së dytë vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për faktin se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 paragrafi 2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK, të cilat gjykata e shkallës së dytë i vështron sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK. Për shkak të hetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike e cila nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor, gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale dhe për këtë arsye aktgjykimi është dashur të ndryshohet dhe kërkesëpadia

e paditësit të refuzohet si e pa bazuar e në bazë të nenit 195/1 nën pikën e) e lidhur me nenin 201 par.1 nën pikën d) të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore.

Paditësi kërkesën për pagesën e tri pagave jubilarë pranë të paditurës e ka parashtruar me datë 12.04.2018, ndërsa padinë pranë Gjykatës kompetente e ka parashtruar me datë 23.04.2018.

Paditësit e drejta për të kërkuar pagat apo shpërblimet jubilarë i është krijuar me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive me datë 01.01.2015, nga kjo datë deri me 01.01.2018 paditësi ka pasur mundësi ta paraqesë padinë. Pas datës 01.01.2018, me skadimin e Marrëveshjes Kolektive, pala humbë të drejtën që të kërkojë shpërblimin jubilar sepse një kërkesë e tillë është e parashkruar apo vjetërsuar dhe për më tepër nuk mund të mbështetet në një mekanizëm i cili është jashtë fuqisë dhe nuk prodhon ndonjë efekt juridike për palët.

Në nenin 90 par.4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të punës ndër të tjera thuhet se *“...Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet...”*, ndërsa në nenin 90.5 të Ligjit Nr. 03/L-212 të punës në mënyrë decisive thuhet se *“...Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive...”*.

Marrëveshja e përgjithshme Kolektive e Kosovës ka filluar të zbatohet nga data 01.01.2015, që i bie që në momentin e parashtrimit të padisë të paditësit nuk ka qenë në fuqi Marrëveshja e përgjithshme kolektive e Kosovës, dhe atë bazuar në nenin 82 të kësaj marrëveshje ku në mënyrë decisive thuhet se *“Kjo Marrëveshje e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e nënshkruar nga Partnerët në Këshillin Ekonomiko – Social të Kosovës, hyn në fuqi nga data 01.01.2015”*, dhe pasi që është kohëzgjatja 3 vjeçare e marrëveshjes së përgjithshme kolektive, ky afat ka skaduar me datë 1 Janar 2018, dhe nga kjo rrjedhë se Kontrata kolektive nuk është vazhduar më tutje dhe mbi këtë bazë aktgjykimi i atakuar është dashur të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit është refuzuar e në bazë të dispozitave të lartë cekura.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën e), e lidhur me nenin 201 par.1 nën pikën d), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.4442/2019, datë 29.09.2021

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Bujar Muzaqi